

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarja ligjore Vjollca Kurtishaj , në çështjen penale kundër të akuzuarit R.N., nga fshati P. Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale Asgjësim ose dëmtim i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.723/2017, datë 01.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30.07.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.723/2017, datë 01.02.2018, **vërtetohet**

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.723/2017, datë 01.02.2018, të akuzuarin R.N., për shkak të veprës penale Asgjësim ose dëmtim i pasurisë, nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtorë dhe e ka dënuar me kushte me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës kohore prej 2 (dy) vite nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kushtë do të revokohet. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil. Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25€, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogaritjes përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, dhe atë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal me propozim që gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe ndaj të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të lartë dhe me dënim me burg efektiv.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.712/2018, datë 09.07.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim me i lart me burg efektiv.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Prokurori aktgjykimin e atakuar e ankimon sa i përket vendimit mbi sanksionin penal duke theksuar se gjykata e shkallës së parë drejt dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, se i akuzuari në ditë kritike në kohë dhe vendin e përmendur ka kryer veprën penale në fjalë, por gjykata nuk i ka shqiptuar dënim meritore të akuzuarit sipas ligjit sepse këtë dënim e zbuti deri në atë masë e cila bihet në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen dhe zbutjen apo ashpërsimin e dënimit dhe kufijtë e kësaj zbutje të përcaktuara me nenet 74,75 dhe 76 të KPRK-së, prokurori theksoi se rrethanat lehtësuese qfardo qofshin ato assesi nuk është dashur të vlerësohen në atë mënyrë që dënimin e paraparë ligjor për veprën penale të kësaj natyre të zbutet deri në këtë masë ku të akuzuarit ti shqiptoj dënim minimal dhe atë me kusht, gjykata në këtë rast për të akuzuarin si rrethana lehtësuese mori praninë e kryerjes së veprës penale, gjendjen e rëndë ekonomike faktin se përveç 3 fëmijëve të tij i njëjti kujdeset edhe për 4 fëmijët e vëllaut të vetë të ndjerë ku dy prej tyre nuk janë të aftë mendërisht, ndërsa kjo gjykatë nuk ka përmendur asnjë rrethanë rënduese si : motivi i kryerjes së veprës penale, pasojat e shkaktuara e shkaktuara sepse kemi të bëjmë me veprën penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë, ku pasojat janë të dukshme, ndezja e instalimit të rrymës dhe aparateve, që do të thotë se edhe rrezikshmëria ka qenë e nivelit të lartë, dhe nëse gjykata do ti kishte vlerësuar në mënyrë të duhur të gjitha këto rrethana sanksioni penal do të ishte më i lart. Prandaj propozoj që gjykata e Apelit në Prishtinë ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ndaj të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burg efektiv.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të prokurorit për shqiptimin e dënimit më të ashpër – dënimi me burgim efektiv për të akuzuarin janë të pabazuara. Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata e shkallës së parë pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të akuzuarin ashtu që si rrethanë lehtësuese mori praninë e fajësisë dhe pendimin për veprën e kryer , gjendjen e tij të

rëndë ekonomike i cili përveç që kujdeset për 3 fëmijët e tij kujdeset gjithashtu edhe për 4 fëmijët e vllait të tij të ndjerë të cilët dy prej tyre nuk janë të aftë mendërisht të cilët po ashtu kanë qenë pjesëmarrës në veprën penale, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti. Sipas bindjes së gjykatës së kësaj gjykate e dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se mund të pritët se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së. Një vlerësim të këtyre të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, pretendimet e prokurorit për një dënim të ashpër –dënim më të lart me burgim efektiv, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të bazuara, ngase duke marrë parasysh peshën e veprës penale dhe rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë del se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, e me qenë se në ankesën e prokurorit nuk theksohet ndonjë rrethanë e re rënduese , që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e që do të ndikonte në një dënim më të ashpër , kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me dënimin e shqiptuar kryerësi do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e peronave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë konform të dispozitave të nenit 401 të KPPK-s u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

PA1.nr.705/18, datë 30.07.2018

Zyrtarja ligjore  
Vjollca Kurtishaj

Kryetari i kolegjit  
Hashim Çollaku

### **Anëtarët e kolegjit:**

Ferit Osmani  
Biljana Rexhiq